



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA SHTIME
OPŠTINA ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME

Drejtoria për Zhvillim Ekonomik
Uprava za Ekonomski Razvoj/Department for Economy Development

Data/Datum/Date:	27.12.2022
Nr./Br./No	04/34
Për/Za/To:	Kryetarin e Komunës, Z. Qemajl Aliu
Nga/Od/From:	Kastriot Shabani, Drejtor i Drejtoris për Zhvillim Ekonomik
Lënda/Predmet/Subject :	Raporti i punes per vitin 2022

Ne bazë të planit të punës së DZHE kemi përmushur gjithë planin e paraparë për vitin 2023.

Si projekte të rëndësishme të drejtorisë kemi Tregun e Gjelbert ku punimet po vazhdojnë sipas dinamikës së paraparë, Në parkun industrial kemi ndërhyrë dhe kemi perfunduar murin mbrojtës që ka qenë kërkesa kryesore e atyre bizneseve që operojnë në atë zonë.

Në Zonën Ekonomike, në Gllavicë, kemi perfunduar projektin dhe hapjen e rrugëve brenda zonës si dhe shtrimin e rrugëve me zhavor dhe vendosjen e puseta për ujëra atmosferikë.

Për këtë zonë jemi në përfundim të të gjitha pëlqimeve. Ka mbetur vetëm pëlqimi nga Minsitria e Bujëqësisë deri në miratimin e PZHK nga ne. Si kërkesë është bërë në ministri, komisioni ka dalë në terren. Na mbetet që pas pëlqimit të aplikojmë në MINT dhe të të marrim statusin e Zonës Ekonomike.

Një ndër projektet e rëndësishme të drejtorisë është ngrohja me biomasë. Duke falënderuar CNVP është kryer plani i fizibilitetit nga ekspertët austriakë. Ata kanë konstatuar që komuna e Shtimes i plotëson të gjitha kushtet për ngrohje me biomasë, Kemi pasë takime me Bankën Botërore për mënyrën e financimit të këtij projekti.

Në kuadër të Drejtorisë kemi krijuar një grup punues për hartimin e Strategjisë.

Planin për menagjimin e tokave ruarale 2023-2025 e kemi nxjerrë si strategji të komunes. Tani e kemi të kompletuar si dokument.

Kemi mbajtur panairin me produktet vendore në Sheshin Ahmet Shtimja ku ka qenë i vizituar nga shumë qytetarë të komunës së sobë.

Kemi perfunduar projektin e nënshkruar në bashkpunim me IAD-në për vitin 2020-2022 bazuar në projektin, Përmirësimi i punësimit dhe mundësive për gjenerim të të ardhurave në zonat rurale ku këtë vit kemi perkrahur 17 përfitues me nga 5000 dhe 3000 euro.

Projekti do të arrijë rezultate të prekshme në perkrahjen e të rinjve me këshilla praktike teorike me qëllim punësimi dhe gjenerimi të të ardhurave me grande dhe vetpunësim.

Kemi perfunduar një fazë në projektin e rregullimit të rrugëve bujqësore me zhavor, ku me këtë projekt janë shtruar 8.7 km dhe pjesën e dytë të vitit kemi filluar dhe me 3 km rrugë bujqësore në fshatrat Muzeqinë, Gllavicë, Vojnovc dhe Mullopoc.

Po ashtu jemi përfitues të projektit nga MBPZHR për rregullimin e kanaleve kulluese që fillona nga Godanci dhe perfundon në fshatin Gjyrkovc.

Spektori për Bujqësi për çdo vit po bën planifikim për mbjelljet pranverore. Këtë vit në komunën tonë janë mbjellur kultura të ndryshme pranverore ku dominon kultura e misrit në sipërfaqen me të madhe.

Pranimi i aplikacioneve të fermerëve për subvencione, pagesa direkte të fermerëve, thirrje e shpallur nga MBPZHR nga data 26.04.2022 deri më 01.05.2022 e ku gjatë kësaj periudhe kanë aplikuar afër 500 fermerë. Kemi dorëzuar dosjet e tyre në AZHB ku i janë nënshtruar kontrollit administrativ dhe kontrollit të terrenit nga ana e zyrtarëve të AZHB-së. Këtyre ditëve janë kryer pagesat.

Kemi implemetuar marrëveshjen e bashkpunimit me Help, ku nga kjo marrëveshje kanë përfituar 35 aplikues në paisje me vlerë 2000€.

Kemi nënshkruar marrëveshje me OZHR për perkrahjen e 13 fermerëve me nga 10 krerë dhi të racës Alpina ku gjatë 3 viteve do të perkrahen me ushqime koncentrat, vaksinim etj.

Kemi shpallur thirrjen për 40 serra për fermerët e komunës sonë, nga 50m², për të cilën kanë aplikuar 214 aplikues. Komisioni për ndarjen e serrave ka dalë në terren dhe ka bërë përzedhjen e tyre.

Pjesëmarrja e zyrtarit për kshillime në trajnimet e organizuara nga MPZHR dhe ILO ër ngritjen e kapaciteteve dhe kshilltarëve publikë.

Komisioni për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësit natyrore dhe dëmet e shkaktuara gjatë ndërtimit të kolektorit të ujërave të zeza ku së bashku me komisionin kemi bërë vlerësimin e dëmit dhe një raport. Komisioni ka hartuar dhe ka bërë dorëzimin në MBPZHR për kompensimin e dëmeve që u janë shkaktuar fermerëve nga fatkeqësitë natyrore.

Po paraqesim në formë tabelare kulturat e planifikuara dhe sipërfaqën për vitin 2022:

Nr rendor	Kultura	Sipërfaqet e planifikuara për mbjellje / ha
1	Misër kokërr	900
2	Misër me fasule	50
3	Misër i gjelbërt	60
4	Elb	10

5	Tërrëshër	50
6	Bimë furragjere	20
7	Bimë industriale	3
8	Perime në serra	7
9	Perime në fushë të hapur	40
10	Patate	20
11	Fasule monokulturë	10
	Gjithësejt	1180

Rapot vjetor 05.01.2022 – 22.12.2022.

1. Sektori për Zhvillim Ekonomik

Tabela pasqyron aktivitetet e Zyrës për Regjistrimin e bizneseve

Nr	Aktivitetet	Numri
1	Regjistrimi i bizneseve të reja	101
2	Shuarje të biznesit	10
3	Ndryshime në biznes (certifikata të biznesit)	53
4	Certifikata të reja (ndërrime nga certifikata e UNMIK-ut)	0
5	Vërtetim për mos posedim të biznesit	5
6	Ndryshime në biznes (shtim veprimtarie)	17
7	Ndryshime në biznes (shtim, heqje njësie)	14
8	Leje të përkohshme për zgjatjen e orarit të punës	0
9	Informata mbi Biznesin	67
10	Certifikata Duplikat	0
11	Certifikata e TVSH së duplikat	0
12	Ndërrim Pronari	18
13	Ndërrim personit të autorizuar	2

Zyra e Pyplltarisë:

Gjithsej 26 fletparaqitje për Gjykatën Themelore- Ferizaj, 24 kundërvajtje, 2 penale